



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**Informatë
për aktivitetet e organeve të Komunës së Prishtinës
në tremujorin e parë të vitit 2008**

Në këtë informatë do të prezantohet aktivitetet, të cilat organet e Komunës së Prishtinës i zhvilluan gjatë tremujorit të parë të vitit 2008. Edhe pse është një kohë shumë e shkurtër, do t'u vej në dijeni edhe për disa aktivitete që kanë të bëjnë me realizimin e Programit tim zgjedhor gjatë kësaj kohe.

Më 3 janar të këtij viti u bë konstituimi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe organeve të saj të dala nga zgjedhjet të cilat u zhvilluan në fund të vitit 2007.

Prioritete të kësaj periudhe kanë qenë:

- Riorganizimi në harmoni me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30
- Përgatitja e projekteve për programet e aprovuara, për t'u implementuar në këtë vit;
- Fillimi i punëve në realizimin e projekteve të përcjellura nga viti 2007;
- Shtimi i efikasitetit të shërbimeve me qytetarë;
- Rritja e mbikëqyrjes së ndërtimeve pa leje dhe ekzekutimi i ndërtimeve të filluara gjatë fushatës zgjedhore
- lirim i hapësirave të qytetit nga disa reklama dhe objektet e tjera të vendosura pa leje;
- Rritja e efikasitetit të ndërmarrjeve publike, sidomos të pastrimit dhe përgatitjet për gjelbërimin e qytetit;
- Harmonizimi i orarit të punës së shërbimeve të komunës me nevojat e qytetarëve dhe aktivizimi i sportelit komunikues me qytetarë;

Fillimi i punës së organeve të Komunës u përball me nevojën e harmonizimit të organizimit të përgjithshëm karshi Rregullores 2007/30, e cila parashihte një strukturim dhe organizim të ri të drejtorive, të komiteteve dhe përgjegjësi specifike të Kryetarit të Komunës.

Kjo periudhë kryesisht ka shërbyer për punët përgatitore, si ato organizative, ashtu edhe punët që kanë të bëjnë me përgatitjen e programeve dhe tenderimin e projekteve, me identifikimin dhe përpunimin e hapësirave për ndërtime kapitale, sidomos për objekte

Faqe 1 nga 12

shkollore, si dhe me përgatitjen e ndryshimeve të disa akteve të Komunës për të krijuar mundësi më të volitshme veprimi.

Konstituimit të drejtorive i ka paraprirë ndërtimi i koalicionit ndërmjet grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së dhe KDTP-së me përkrahje të grupit parlamentar të AAK-së më 20 shkurt të vitit 2008.

Nga Programi i premtuar qytetarëve, gjatë kësaj periudhe janë realizuar apo kanë filluar të realizohen si vijon:

- Ka filluar të definohet me ligj statusi i veçantë i Prishtinës, si qytet, pasi që Prishtina është shpallur me Kushtetutë për kryeqytet të vendit;
- Pas presioneve të bëra nga Komuna, Bordi Rregullativ ka hequr monopolin e kompanisë për pastrimin e qytetit,
- Janë bërë ndryshime esenciale në Këshillin e Drejtorëve dhe është ekipuar kabineti me ekspertë të rinj, në cilësi të këshilltarëve;
- Kanë filluar përgatitjet për Prishtinën e Re, revidimi i planeve rregulluese të cilat nuk mund të implementohen, hapja dhe rregullimi i shesheve të qytetit, ekzaminimi i granitit në qytet, rrënimi i objekteve pa leje;
- Janë përgatitur vendimet dhe Kuvendi ka vendosur për uljen e tarifave për ndërtime nga ky vit dhe për uljen e tatimit në pronë nga viti 2009;
- Kanë filluar përgatitjet për ndërtimin e Rrugës Unazore Qendër; është duke u hartuar projekti zbatues, kurse Kuvendi ka ndarë 1 milion euro për ndërtimin e saj;
- Është rrumbullakuar Projekti i Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe është bërë identifikimi i projekteve kapitale të zhvillimit;
- Është harmonizuar orari i punës me nevojat e qytetarëve dhe aplikimi i orarit rrëshqitës;
- Janë marrë masa për zvogëlimin e tolloive në sportelet ku lëshohen dokumente në përgjegjësi të Komunës;
- Është kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të bëhet zhvendosja e zyrave të tyre që lëshojnë dokumentacion personal nga objekti i Komunës, në mënyrë që të jenë nën mbikqyrje të Ministrisë në përgjegjësinë e së cilës janë;
- Po aplikohet punë ekipore me drejtorë në trajtimin e çështjeve për interes të Komunës;

Statusi i Prishtinës

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Prishtina ka fituar statusin e Kryeqytetit. Pavarësia e vendit tonë por edhe përcaktimi kushtetues i Prishtinës si kryeqytet i Kosovës është një e arritur e madhe e popullit të Kosovës, njëherit edhe një përgjegjësi e veçantë e qytetarëve të Prishtinës. Organet e Komunës së Prishtinës dhe qytetarët tanë me sukses kanë organizuar të gjitha punët nga fushëveprimi i tyre me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe kemi punuar dhe jemi në vazhdim të punës me Ministrinë e Pushtetit Lokal, që Prishtina si kryeqytet të fitojë autorizime dhe përgjegjësi specifike në krahasim me komunat e tjera të Kosovës. Kemi zhvilluar disa takime dhe konsultime

profesionale me grupet e ekspertëve për hartimin e Ligjit mbi Prishtinën, i cili pritet të përfundojë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Me këtë Ligj, Komuna e Prishtinës duhet të fitojë status të qytetit, i organizuar në distrikte, në të cilat do të barten të gjitha shërbimet që duhet të jenë më afër qytetarëve dhe të cilat nuk e cenojnë unitetin e përgjegjësive të Prishtinës si qytet dhe nuk krijojnë asimetri me organizimin e sistemit lokal në Kosovë. Prishtina, po ashtu, do të ketë rol metropolian në bashkëpunim me komunat fqinje.

Është përgatitur dhe aprovuar Statuti i Komunës së Prishtinës në harmoni me Rregulloren 2007/30 të UNMIK-ut. Në përgatitjen e Statutit ka punuar grupi punues i caktuar nga Kuvendi i Komunës, i cili me një përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë ka arritur të përgatis një tekst përmbajtësor dhe cilësor, të organizojë dhe të zhvillojë debatin publik me qytetarët, grupet e interesit nga ekonomia, arsimit, shëndetësia, ndërmarrjet publike, si dhe me shoqërinë civile. Në ngritjen e cilësisë së këtij Statuti si dhe në saktësimin dhe precizimin e tij më të afërt kontribut të veçantë kanë dhënë edhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës, në dy seanca të Kuvendit dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Organet e komunës, po ashtu janë angazhuar aktivisht në dhënien e kontributit, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në Ligjin mbi Qeverisjen Lokale, të cilin në fillim të këtij viti e aprovoi Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në bazë të organizimit të ri, të përcaktuar me Statut, administrata komunale organizohet në 8 drejtori: Drejtoria e Administratës dhe Personelit, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ndërtimeve Infrastrukturale dhe Drejtoria e Pronës.

Me përkrahje të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur janë angazhuar tre këshilltarë të Kryetarit për fusha të caktuara: për strategji zhvillimore dhe integritime evropiane, për organizimin e pushtetit lokal, dhe për media, kurse me përkrahje të Zyrës britaneze është angazhuar një arkitekthe për planifikim urban dhe hapësinor. Me këtë është krijuar një diversitet në përballimin e nevojave konkrete nga drejtoritë dhe atyre interdisciplinare.

Gjatë kësaj periudhe vërehet se organizimi dhe funksionimi i drejtorive përballen me dy sfida të veçanta. E para, disa nga drejtoritë janë shumë të mëdha dhe heterogjene për nga përbërja e tyre, siç janë Drejtoria e Administratës dhe Personelit, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe, po ashtu, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës. E dyta, shuarja e Drejtorisë së Inspeksionit dhe shpërndarja e saj në drejtoritë amë, është shprehur pozitivisht në sigurimin e lidhjes organike ndërmjet planifikimit, realizimit dhe kontrollit por, po ashtu, ka ndikuar që këto drejtori të mbingarkohen dhe të humbin fokusimin në disa detyra të veçanta.

Sa i përket Inspeksionit, dëshiroj të nënvizoj, se gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje të komunikojmë me inspektorët dhe t'i vejmë në lëvizje, sidomos inspeksionin e

ndërtimeve por edhe atë komunal dhe të tregut. Kemi bërë edhe disa lëvizje kadrovike, por puna e inspektorëve nuk është e kënaqshme. Veprimet në terren kryesisht bëhen në bazë të ndërhyrjeve nga udhëheqësit e lartë, ndërkaq mungon përgjegjësia, iniciativa dhe disiplina në punë. Për tejkalimin e përkohshëm të këtyre problemeve deri në pranimin e inspektorëve dhe referentëve të rinj dhe themelimit të Policisë ndërtimore do të shfrytëzohet angazhimi i operatorëve privat në përcjelljen e ndërtimeve pa leje dhe të punëve komunale, kurse punët administrative të mbikqyrjes dhe inspektimit do t'i bëjë një grup zyrtarësh nga shërbimi civil i komunës. Karshi kësaj do të vlerësohet puna e çdo inspektori si dhe e punonjësve të tjerë në të gjithë sektorët. Individëve, të cilët do të vlerësohen me performansa të dobëta, nuk do t'u vazhdohet kontrata e punës pas muajit qershor të këtij viti.

Çështja e integriteteve po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme karshi nevojës dhe prioriteteve të përcaktuara nga institucionet e Kosovës për integrim të plotë në BE. Në përputhje me këtë orientim strategjik të vendit, komuna ka marrë vendim për themelimin e zyrës për integritete evropiane. Stafi i kësaj zyre do kompletohet në muajt në vijim dhe ai do ketë përgjegjësi për koordinimin e aktiviteteve të komunës në përputhje me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian të miratuar nga Qeveria e Kosovës. Komuna ka filluar tani më një program me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ku është bërë trajnimi disa ditor 7 zyrtarëve komunal në lidhje me çështjet e integriteteve evropiane. Programi i trajnimit të zyrtarëve komunal me këtë fondacion do të vazhdojë.

Kuvendi i Komunës dhe organet e tij

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur tre mbledhje të Kuvendit të Komunës, në të cilat kryesisht janë trajtuar çështje të konstituimit të organeve, zgjedhjes së trupave punuese dhe aprovimit të akteve normative. Punën e Kuvendit e përshkon një përkushtim i lartë i anëtarëve për trajtimin dhe vënien e themeleve të qëndrueshme për zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat do të ballafaqohemi në të ardhmen. Kuvendi ka zgjedhë të gjitha komitetet, ka emëruar zëvendës-kryesuesit dhe është konsultuar/informuar për emërimin e ushtruesve të detyrës së drejtorëve dhe pastaj të drejtorëve të drejtorive.

Në punën me drejtorët e drejtorive është zbatuar një frymë ekipore. Janë organizuar takime joformale ditore dhe javore për trajtimin dhe përgatitjen e vendimeve dhe akteve si dhe të aktiviteteve që kanë pasuar. Ndërkaq, për aktet të cilat i janë drejtuar kuvendit dhe për ato për të cilat është vlerësuar e nevojshme janë mbajtur mbledhje të Këshillit të Drejtorëve.

Vlerësoj se gjatë kësaj periudhe kemi arritur një bashkëpunim të mirë me përfaqësuesin e UNMIK-ut, me përfaqësuesit e OSBE-së, të KFOR-it dhe të SHPK-së.

Menaxhimi hapësinor dhe urban

Në këtë fushë është punuar sidomos në përgatitjet për planet e reja rregulluese, në krijimin e kushteve për implementimin e planeve ekzistuese rregulluese, në lehtësimin dhe thjeshtësimin e procedurave të lëshimit të lejeve të ndërtimit dhe në shtimin e kontrollit të ndërtimeve pa leje.

Kemi anuluar tenderin për Planin Rregullues "Prishtina e Re", sepse ai kishte përfshirë një sipërfaqe prej rreth 2 mijë hektarëve, që sipas vlerësimit të ekspertëve nuk përkonte me mundësitë që për një sipërfaqe të tillë të hartohet plan rregullues. Në vend të kësaj, kemi shpallur dhe përfunduar konkursin për Konceptin e Prishtinës së Re, me të cilin kërkohet të përcaktohen: struktura e organizimit, destinimet e territorit sipas nevojave dhe prioritetet e përpunimit në pjesë të veçanta të kësaj hapësire me projekte rregulluese. Është përgatitur vendimi për ndryshimin e vendimit mbi realizimin e Planit Rregullues të Lagjes Tophane, i cili më vonë është aprovuar nga Kuvendi. Janë bërë përgatitje për zhvillimin e konsultimeve profesionale për konceptin urban dhe organizimin përmbajtësor të qendrës së qytetit, sidomos Sheshit "Nëna Terezë". Është filluar me hapjen e Sheshit të Pavarësisë dhe së shpejti do të fillojë rregullimi i pjesshëm i këtij sheshi. Janë dërguar mostrat e pllakave të granitit nga Sheshi "Nëna Terezë" për t'u ekzaminuar në një institut të jashtëm, për të vërtetuar qëndrueshmërinë dhe nivelin e radioaktivitetit. Ky ekzaminim do të zgjasë deri në mes të muajit qershor.

Në fushën e inspektimit të ndërtimeve janë bërë kontrole dhe evidentime të ndërtimeve të larta me leje dhe pa leje dhe është hartuar një raport i këtyre ndërtimeve. Brenda 3 muajve janë rrënuar 33 objekte pa leje.

Është përgatitur Vendimi për tarifën për ndërtime, i cili është aprovuar nga Kuvendi Komunal. Sipas këtij vendimi tarifa për ndërtime janë zbritur në mesatare prej 25% për të stimuluar ndërtimet sipas kushteve urbanistike dhe për të evituar ndërtimet pa leje. Zbritja e këtyre tarifave do të rrisë numrin e atyre që paguajnë për ndërtime, do jetë tërheqëse për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje gjatë implementimit të Ligjit mbi legalizimet dhe do të ketë efekte të drejtpërdrejta pozitive në rritjen e buxhetit të Komunës në të ardhmen. Po ashtu janë hapur mundësitë e kompensimit me tarifa komunale të tokës e cila merret për ndërtime për nevoja publike.

Rrugët unazore

Është shpallur tenderi dhe është zgjedhur firma për hartimin e projektit për pjesën veriperëndimore të unazës qendër. Me ndërtimin e kësaj unaze vlerësohet se do të ulët dukshëm presioni automobilistik në qytet nga hyrja e Podujevës dhe pjesës së Gollakut. Gjatë kësaj periudhe kemi konkurruar në programin IPA për donacione për ndërtimin e kësaj unaze, ndërsa nga mjetet e buxhetit të fituara nga granti qeveritar për tatimin në pronë Kuvendi ka ndarë 1 milion euro për fazën e parë të saj. Kanë filluar përgatitjet edhe për ndryshimin e pjesës së Unazës së brendshme, për të evituar kalimin e saj mbi varrezat e qytetit, për ta racionalizuar koston e saj dhe për ta përgatitë për hartimin e projektit kryesor.

Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit i janë ofruar kushtet urbanistike për ndërtimin e nënkalimeve për Kalabri te Hotel Viktoria dhe afër Stacionit të Autobusëve. Kësaj ministrie i kemi shtruar kërkesë për financimin e disa rrugëve urbane dhe rurale dhe jemi në pritje të një përgjigjeje, ashtu siç është vepruar me komunat tjera.

Organet gjegjëse të komunës kanë punuar edhe në projektimin dhe përgatitjet për tenderimin e nënkalimit të objekti i KEK-ut, në anën e djathtë të Katedrales. Është punuar në përgatitjen edhe të projekteve të tjera për t'u tenderuar me koncesion.

Infrastruktura rrugore

Në janar të këtij viti janë kontaktuar punë-kryesit dhe janë konkretizuar detyrimet për vazhdimin e punimeve për infrastrukturën e kontraktuar në vitin e kaluar, të përcjellur në këtë vit, për rrugët: Maliq Pashë Gjinolli, Mbreti Bardhyl, Eduard Lir, Bajram Curri, Shpati në Mat, rruga lidhëse Isa Kastrati, largimi i ujërave të zeza nga kanali i Hidrosistemit Ibër Lepenc, Metush Krasniqi, Ismajl Ismajli, rruga në Sofali dhe rrugës Sushicë-Janjevë. Gjatë tremujorit të parë është përfunduar rruga Metush Krasniqi dhe rruga Mbretëresha Teuta.

Problemet më të mëdha gjatë kësaj periudhe i kemi pasur me përfundimin e projektit në rrugën Vëllezërit Fazliu (rruga për Podujevë në Kodrën e Trimave). Meqenëse gjatë kontraktimit të kësaj rruge nuk ishte marrë parasysh infrastruktura nëntokësore, rrjeti i ujit, rrjeti optik i telefonisë dhe rrjeti magjstral i tensionit të lartë të rrymës, në pamundësi që të bëjmë ndryshime të mëdha në punët e tenderuara dhe të kontraktuara, ishim të detyruar të zhvillojmë negociata me Ujësjiellësin Rajonal "Prishtina" me PTK-në dhe KEK-un dhe më vonë edhe me IPK-on për të kërkuar përkrahjen e tyre për përfundimin e këtyre punëve, të cilat ishin parakusht për vazhdimin e ndërtimit të rrugës. Pas disa kontakteve dhe marrëveshjeve gjatë muajit janar, shkurt dhe mars, IPKO-mori mbi vete që me shpenzime të saj të shtrojë kanalet për rrjetin e rrymës së lartë, ku do të vihej edhe rrjeti i IPKO-s, PTK-ja shpalli tenderin për përforcimin e kabllit optik, kurse Komuna mori mbi vete shpenzimet për blerjen e kyçjeve për lidhjet e reja me ujë të mbi 300 familjeve, të cilat kyçje i kreu Ujësjiellësi "Prishtina". Vlera e këtyre punimeve shtesë vlerësohet të kalojë rreth 35% e vlerës së projektit, të cilat fonde kryesisht bien mbi barrë të këtyre kompanive. Zgjatja e punimeve ka vështirësuar jetën e popullatës në këtë pjesë dhe ka dëmtuar shumë bizneset.

Për investimet tjera në qytet që duhet realizuar këtë vit, gjatë kësaj periudhe janë bërë inçizimet e rrugëve: Rexhep Krasniqi, Agim Qela, Tahir Zajmi, Mentor Retkoceri, Andrea Gropa, Bedri Pejani, Fazli Grajqevci, Malush Kosova, rruga pas Ministrisë së Shërbimeve Publike, parkingu në lokacionin e Bregut të Diellit dhe stazave të këmbësorëve te stacioni i autobusëve. Janë hartuar raportet teknike, financiare, situacionet, profilet gjatësore dhe profilet tërthore të këtyre rrugëve.

Janë hartuar detyrat projektuese dhe janë dërguar në Drejtorinë e Administratës dhe Personelit për tenderim për: rrugën: Prapashticë Hajkobilë - Glllogovicë, Llukar – Siqevë, Slivovë-Viti e Marecit, Badovc-Sushicë-Shashkocv, rruga nga magjistrala Prishtinë-Gjilanolagja e Byqmetëve, Bardhosh Milec, Besi-Lagja Bllacaj dhe kanalizimi fekal në Hajvali.

Janë hartuar përmasat dhe janë bërë parallogaritë për ndërtimin e rrugëve me zhavor për këto rrugë: Marevc – lagja e Gërbeshëve, Koliq – lagja Hajdaraj, Koliq- lagja Peraj, Koliq – lagja Qokaj, Rimanishtë, prej xhamisë deri te shkolla fillore, Grashticë- lagja e Cërvadikëve, Prapashticë: Llapsidejë-lagja e Sjarinëve, Lagja e Govorëve, Cubaj-Ramiq-Balaj.

Së bashku me përgjegjësit e drejtorive përkatëse dhe zyrës së prokurimit, Kryetari i Komunës disa herë ka vizituar pjesët e veçanta të qytetit dhe Komunës për tu njohur në terren me gjendjen dhe nevojat konkrete për ndërtime. Jemi përqëndruar sidomos në Lagjen Kalabria, në Lagjen e Spitalit, në lokacionin te Bunari i Hajratit dhe në disa rrugë në Kodrën e Trimave. Kemi vlerësuar të domosdoshme fillimin e ndërtimit të rrugëve përgjat Lagjes Kalabria dhe marrjen e masave për ndërtimin e kolektorëve në pjesën lindore dhe perëndimore të lumit Prishtina.

Ekonomi dhe Financa

Në tremujorin e parë është punuar në revidimin e Planit Strategjik të zhvillimit të Prishtinës për periudhën 2008-2011. Janë zhvilluar kontakte me palët me interes për sigurimin e bashkëpunimit me Aleancën e qyteteve me Seli në Washington D. C. për

ndërtimin e një partneriteti për shfrytëzimin e përvojave më të avancuara për zhvillimin e kompleksit social, ekonomik dhe urban.

	Të hyrat nga tatimi në pronë		
	2007	2008	Indeksi
Janar	159,874.52	145,957.16	91.3%
Shkurt	219,927.98	95,645.89	43.5%
Mars	184,267.64	154,475.31	83.8%
Prill	276,468.02	464,347.82	168.0%
Gjithsej	840,538.16	860,426.18	102.4%

Trendët në të hyrave komunale në muajin janar dhe shkurt nuk ka qenë të volitshme. Ato janë përmirësuar dukshëm në muajin mars dhe prill. Burimet më të qëndrueshme të të hyrave komunale janë tarifat për ndërtime dhe tatimi në pronë.

	Të hyrat nga lejet e ndërtimit		
	2007	2008	Indeksi
Janar	92,847.94	4,896.00	5.3%
Shkurt	385,866.00	461,196.82	119.5%
Mars	223,055.72	519,270.58	232.8%
Prill	550,080.95	372,790.27	67.8%
Gjithsej	1,251,850.61	1,358,153.67	108.5%

Janë përgatitur 35 projekte, të cilat i janë dorëzuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave si ide për Konferencën e donatorëve sipas këtyre fushave: Zhvillimi i bizneseve 5 projekte, zhvillimi rural 6 projekte, infrastruktura fizike 13 projekte, arsimit 3 projekte, shëndetësia 3 projekte, shërbimet publike 2 projekte, mbrojtja e ambientit 1

projekt dhe sport, kulturë dhe rekreacion 2 projekte. Kostoja totale e këtyre projekteve sillet 201.4 milion €. Po ashtu, janë përgatitur 9 propozime, të cilat i janë dorëzuar

Ministrisë së Pushtetit lokal, për tu financuar nga programi IPA, 4 nga arsimit, 2 nga infrastruktura rrugore, 2 nga infrastruktura ujore dhe një nga shëndetësia.

Është përgatitur Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit mbi Tatimin në Pronë me të cilin është bërë ulja e tatimeve në pronë prej rreth 25%, kurse hyrja në fuqi e këtij vendimi bëhet nga data 1 janar 2009. Krahas kësaj po bëhen përpjekje për organizim më efikas të arkëtimit të tatimit në pronë.

Arsimi dhe kultura

Është organizuar puna në ndërtimin dhe fillimin e ndërtimit të gjithsej 15 objekteve shkollore, të cilat do të bëhen sivjet në komunën tonë, prej tyre janë 3 objekte që përcillen nga viti i kaluar kurse 12 objekte fillojnë këtë vit.

Vazhdojnë punët për ndërtimin e shkollës fillore në Lagjen e Spitalit, në Lagjen e Vreshtave si dhe të shkollës në Llukar, të cilat janë përcjellur nga viti i kaluar. Përfundimi i këtyre tre shkollave pritet të ndodhë në fund të muajit gusht, në mënyrë që ato të jenë të gatshme për vitin e ardhshëm shkollor.

Janë bërë përgatitjet për fillimin e ndërtimit të 6 shkollave me financim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: Shkollës Fillore në Sofali, dhe asaj në Kalabri, Shkollës profesionale për IT, Gjimnazit Xhevdet Doda, Shkollës së Muzikës dhe Shkollës për fëmijë me nevoja të veçanta.

Është punuar në përgatitjen e projekteve dhe hapësirave për ndërtimin e shkollave të cilat financohen nga buxheti komunal: Shkolla fillore në Glllogovicë, Shkolla Fillore në Dabishec, Shkolla fillore në Halitaj, Shkolla fillore në Koliq – Podaj, Shkolla Fillore në Arbëri, mbindërtimit në Vranidoll dhe 5 sallave të edukatës fizike nëpër shkolla.

Është përfunduar dhe inauguruar shkolla fillore në Lagjen Mat, ndërkaq gjatë kohës së pushimeve verore planifikohet të rregullohet oborri i kësaj shkolle dhe të bëhen disa intervenime në kulm, të cilat kanë qenë lëshime projektuese.

Dëshiroj t'u informoj se në ndërkohë kemi arritur marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ndërtimin edhe të dy shkollave shtesë: Shkollës në Bardhosh dhe asaj në Keqekollë, prandaj sipas kësaj sivjet do të jenë në ndërtim 17 objekte shkollore. Kjo do të ndihmojë dukshëm në shkurtimin e ndërrimit të tretë dhe të katërt në shkollat tona.

Është vazhduar me punët në restaurimin e ndërtesës së Hamamit të Madh, në ndërtimin e Qendrës Rekreative të fëmijëve në Parkun e Gërmisë dhe në Arkivin e Prishtinës.

Kanë filluar konsultimet me ekspertë të Bearingpointit (të USAIDit) për të dizajnuar dhe përgatitur në detale të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të implementuar projekte në formë të partneritetit publik-privat për ndërtimin e çerdheve të fëmijëve. Kjo do të bëjë të mundur që përmes sektorit privat të rritet dukshëm pjesëmarrja e fëmijëve në çerdhe. Në këto projekte komuna pritet të mbulojë një pjesë të kostos variabile të funksionimit të çerdheve (dhe pjesa tjetër nga prindërit), ndërsa investitorët privat do i mbulonin investimet kapitale.

Shërbimet publike

Është riorganizuar Drejtoria e Shërbimeve Publike, e cila ka përfshirë pjesën e Drejtorisë së mëparshme të shërbimeve publike (pa pjesën e infrastrukturës) dhe Drejtorinë e Emergjencës.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë aksione për pastrimin e qytetit. Në aksionin me rastin e Ditës së Pranverës janë pastruar pikat më të ndotura të qytetit, nga të cilat brenda 3 ditëve janë nxjerr jashtë rreth 250 kamionë me mbeturina. Mirëpo kjo ka qenë e pamjaftueshme për të sanuar gjendjen për shkak të deponimit afatgjatë të mbeturinave në qytet, sidomos në lokacionin te Bunari i Hajratit, në Rrugën Amet Krasniqi në Arbëri, në lokacionin e ish tregut pas Pallatit të Rinisë dhe te Banosat e Bardha. Heqja e këtyre mbeturinave do të vazhdohet me një projekt të veçantë brenda këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe, pas shumë mospajtimesh, është arritur marrëveshja me Rregullatorin e ujit që të de-rregullohet tregu i larjes së qytetit, pra të hiqet monopoli, kështu që pastrimi i qytetit nga 18 prilli i këtij viti është mundësuar të bëhet me firma konkurruese, duke përfshirë operatorët privat dhe ata publik. Mendoj se kjo do të përmirësojë gjendjen e larjes së rrugëve. Në ndërkohë, deri në ndryshimin e Rregullores, bartja e mbeturinave, sipas Rregullatorit, mbetet monopol i kompanisë "Pastrimi".

Janë ndërmarrë masa për heqjen e reklamave të cilat janë vënë pa leje në rrugët e qytetit dhe jashtë lokacionit të përcaktuar nga urbanizmi. Është përcjellur mbarëvajtja e transportit publik dhe së bashku me SHPK-në janë marrë masa për evitim të operatorëve të paregjistruar. Është ndërprerë shfrytëzimi me koncesion në parkingjet publike në rrugë me pagesë dhe është përgatit tenderi për dhënien me koncesion të shfrytëzimit të parkingjeve. Me Bankën Botërore dhe Ministrinë e Transporteve dhe Post-Telekomunikimit ka filluar të realizohet projekti "Asistencë transportit urban të Prishtinës".

Në muajin mars, në qendër të Prishtinës, ndodhi një shpërthim me bombolë të gazit, nga i cili si pasojë humbën jetën dy qytetarë të Prishtinës dhe disa të tjerë u plagosën. Organet e Komunës vërtetuan se pjesa dërmuese e pompave të gazit por edhe ato të karburanteve nuk kishin leje të punës. Kryetari i komunës mori vendimin për ndalimin e shitjes së gazit brenda qytetit të Prishtinës, zhvendosjen e bombolave të gazit jashtë qytetit, kontrollin dhe rishikimin e vendimeve për të gjitha pikat e shitjes së karburanteve në qytet. Shfrytëzimi i gazit nga qytetarët dhe industria do rritet në vazhdimësi. Kështu që ne tani po mendojmë për një rregullore që do përcaktonte kushtet teknike detale për hapjen dhe operimin e pompave të gazit jashtë qytetit.

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Në tremujorin e parë është aktivizuar ndërtesa e Qendrës së Mjekësisë familjare në Kodrën e Trimave. Për shkak të kufizimeve buxhetore nuk është arritur të sigurohet personel i ri mjekësor, por personeli i caktuar në këtë Qendër është rishpërndarë nga institucionet e tjera të shëndetësisë së komunës.

Së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë është punuar në përgatitjen e programit ideor për spitalin e qytetit. Propozimi i është dërguar Ministrisë së Pushtetit Lokal për t'u financuar nga donatorët IPA si dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për t'u financuar nga donatorët (në konferencën e donatorëve)

Drejtoria, përmes një komisioni të caktuar nga Kryetari i Komunës ka bërë kontrollin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kodër të Trimave dhe të asaj në Kalabri dhe ka vërtetuar shumë lëshime gjatë ndërtimit, që kanë të bëjnë me depërtimet e ujit nga kulmet si dhe me mbetjen e stoqeve të pajimeve, të cilat nuk janë pranuar. Drejtoria ka vlerësuar se këto dy objekte janë të njëjta sipërfaqeje shumë të madhe dhe për pasojë do të kërkojnë shpenzime të mëdha të ngrohjes, pastrimit dhe mirëmbajtjes.

Kjo drejtori është ballafaquar me një numër të madh kërkesash për zgjidhjen e problemeve sociale të qytetarëve, sidomos ato që kanë të bëjnë me punësimin, strehimin dhe ndihmat e veçanta.

Çështjet pronësore

Sfidat themelore kanë qenë kompletimi i Drejtorisë së Pronave me personel të nevojshëm. Gjatë kësaj periudhe nuk është arritur një nivel i kënaqshëm i kompletimit, edhe përkundër angazhimit të drejtorit të kësaj Drejtorie, për shkak të kufizimeve buxhetore në punësim të vëna nga Qeveria Qendrore.

Kompletimi i kësaj drejtorie është e domosdoshme për të zgjidhur problemet esenciale pronësore që e rëndojnë këtë komunë, të cilat mund jenë edhe më të mëdha se problemet e ndërtimeve pa leje. Prona komunale në disa raste është tjetërsuar dhe uzurpuar. Duhet të rivlerësohet dhënia në shfrytëzim e saj, të lirohet nga objektet e ndërtuara pa leje dhe të rishqyrtohen të gjitha vendimet gjyqësore me të cilat pa të drejtë është tjetërsuar prona komunale.

Sa u përket punëve të tjera, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar në pikëpamje pronësore objektet në Sheshin e Pavarësisë. Është vërtetuar statusi i tyre pronësor dhe kanë filluar negociatat me pronarët. Janë zhvilluar negociatat me kompaninë komunale "Prishtina" nën menaxhimin e së cilës kanë qenë një pjesë e këtyre lokaleve.

Ka filluar trajtimi pronësor i disa objekteve dhe pronave individuale dhe komunale në Lagjen Dodona, nga Xhamia e Qarshisë deri te Rruga Bajram Kelmendi, për krijimin e kushteve për ndërtimin e një objekti të kombinuar për biznese dhe banim në këtë pjesë dhe rrënimin e objekteve të vjetra, të cilat e shëmtojnë pamjen e qytetit, e që gjenden vizavi ndërtesës së Kuvendit të Kosovës.

Po ashtu, ka filluar trajtimi i disa pronave në zonën industriale në drejtim të Fushë Kosovës.

Administrata dhe personeli

Proceset e riorganizimit dhe të harmonizimit të organeve të Komunës me Rregulloren 2007/30 kanë konsistuar edhe në organizimin e administratës dhe personelit në Komunë. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë masat e para për riorganizim, të cilat i konsideroj vetëm si fillestare. Këto masa kanë pasur për qëllim sidomos rritjen e efikasitetit në shërbimin e qytetarëve për marrjen e dokumentacionit të gjendjes civile. Me Ministrinë e Punëve të Brendshme janë organizuar dy takime ku është kërkuar që të zhvendosen zyrat e kësaj Ministrie përkatësisht Qendra Komunale e Regjistrimit Civil nga lokalet e Komunës, të cilat lëshojnë dokumente personale – leje të njoftimit dhe pasaporta. Kjo iniciativë është ndërmarrë për arsye se komuna nuk ka përgjegjësi dhe autorizime menaxhuese mbi këto shërbime, kurse qytetarët vërejtjet e tyre i adresojnë në komunë.

Komuna ka përcaktuar orarin e ri të punës dhe orarin rrëshqitës për periudhën verore ku do punohet edhe në orët e vona. Ky orar do tu përshtatet më tepër qytetarëve sidomos gjatë ditëve të verës kur do të ketë presion të nxënësve që regjistrohen në shkolla dhe të bashkatdhetarëve që vijnë në pushime tek familjet e tyre. Për të lehtësuar orientimin e palëve dhe për të ndihmuar palët të cilat kanë nevojë, është aktivizuar sporteli për shërbime qytetarëve. Është formuar Komisioni për Auditimin e Brendshëm, Komisioni Disiplinor dhe ai i ankesave.

Janë marrë masa për përshtetimin e përfundimit të objektit të Komunës në Arbëri. Është kontraktuar fasadimi i këtij objekti, ndërkaq përmes Drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik si dhe asaj të Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është konkretizuar marrëveshja me Bankën Botërore për vazhdimin e donacionit për pajisjen e lokaleve të Kadastrit dhe Gjeodezisë në këtë objekt. Në ndërtesën e Komunës është ndërruar kulmi i Sallës së kuvendit dhe janë ndërmarrë punime në infrastrukturë.

Janë zvogëluar shpenzimet e përgjithshme të komunës. Për tre muaj, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet e karburanteve janë zvogëluar për 24%, të telefonisë fikse për 26% dhe të bufesë për 20%.

Që nga muaji janar janë zbatuar masa për shfrytëzimin racional të parkut të automjeteve. Këto masa kanë ndikuar në kursime dhe racionalizim të shfrytëzimit të makinave.

Relacionet me mediat

Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje për të vënë kontakte më të afërta me të gjitha mediat që përcjellin aktivitetet e Komunës. Në këtë drejtim mund të vërehen disa rezultate të caktuara. Por, ende ekzistojnë dallime të theksuara në paraqitjen e gjendjes në Komunë nga media të ndryshme dhe nga gazetarët dhe redaksitë e tyre. Dëshiroj të konstatoj se as unë dhe as Komuna në tërësi nuk jemi kursyer jo 100 ditë por asnjë ditë nga kritikët dhe sulmet me vend dhe pa vend të mediave gjatë kësaj periudhe. Nuk jemi kursyer edhe nga ofendimet. Edhe përkundër kësaj do të vazhdoj të bëj përpjekje për krijimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit dhe të klimës e cila mënjanon fushatën që vërehet në disa media dhe promovon prezantimin sa më real të gjendjes dhe të probleme jetike dhe praktike në interes të të gjithë qytetarëve.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 031-630, më.21.5.2008

KRYETAR I KOMUNËS

Prof.dr. Isa Mustafa